

NJË MONOGRAFI FAMILJARE ME TEMATIKË ORIGJINALE

Mujë S. Berisha & Fahri B. Hoxha, *Familja emblematike Myftiu – begati e traditës atdhetare, arsimore dhe fetare* (monografi historike dhe gjenealogjike), "Faik Konica", Prishtinë, 2021.

Në këtë monografi autorët Mujë S. Berisha dhe *Fahri B. Hoxha* (tani i ndjerë) kanë ndriçuar me mjeshtri historikun e njërës prej familjeve më në zë shqiptare nga gjysma e shek. XIX deri në vitet 50 të shek. XX. Kjo është arritur falë punës ngulmuese dhe mbështetjes në materialet arkivore, sidomos të fondeve dhe koleksioneve të kësaj familjeje, pastaj në dokumente të botuara, në kujtime të protagonistëve të këtyre zhvillimeve si dhe në publikimet historiografike e publicistike.

Meritë e veçantë e autorëve është përcaktimi për trajtimin e historikut të një familjeje nga shtresa e kamur e shoqërisë shqiptare që nuk ka ndodhur asnjëherë më parë në mjedisin tonë. Është shumë interesante dhe udhërrëfyese për studiuesit e tjerë trajektorja e shtegtimin të kësaj familjeje nga Mirdita ku kishin gjetur strehë nga rrebeshi barbar i Serbisë mesjetare për në trojet e origjinës, si dhe bashkëpunimi e kultivimi i marrëdhënieve tradicionale ndërjetare me mirditorë të tjerë të vendosur në Prishtinë dhe në trevat e tjera të Kosovës.

Monografia "*Familja emblematike Myftiu*" është një burim i pasur njohurish për familjen Myftiu, gjenealogjinë dhe veprimtarinë e shumë përfaqësuesve të saj në periudha të ndryshme, madje në një shkallë të gjerë deri në përmasa kombëtare. Për nga fusha e studimeve që përfshin, është një arritje e mirëpritur jo vetëm për historianë, por edhe për etnologë, ekonomistë, sociologë, gjuhëtarë etj., të cilëve u ofrohet mundësia për t'u njohur më shumë dhe më mirë me këtë familje të gjerë, e cila, me gjithë rolin e madh dhe kontributet e jashtëzakonshme që ka dhënë në zhvillimet tona kombëtare në disa drejtime: politikë, ekonomi, arsim, fe, sport, humanizëm etj., deri në fund të shek. XX ka qenë e anatemuar dhe, të thuash, plotësisht e eklipsuar.

- Një qasje objektive dhe origjinale

Autorët Mujë S Berisha dhe Fahri B. Hoxha i janë qasur në mënyrë origjinale dhe objektive trajtimit të veprimtarisë së përfaqësuesve të

familjes Myftiu, qoftë në aspektin ekonomik, kulturor, arsimor, fetar, humanitar etj., qoftë në fushën e veprimtarisë atdhetare, madje, në këtë drejtim në mënyrë të veçantë. Kështu, libri monografik *“Familja emblematike Myftiu – begati e traditës atdhetare, arsimore dhe fetare (monografi historike dhe gjenealogjike)”* i këtyre autorëve tashmë të dëshmuar në letrat shqipe, ngërthen në vetvete tri fusha kryesore: histori, etnografi dhe ekonomi. Është meritë e veçantë e autorëve, të cilët kanë arritur me mjeshtri që t’iu shmangen klisheve të historiografisë “marksiste”, që, siç theksuam më lart, i ka anatenuar pa përjashtim dhe ka injoruar rolin dhe kontributin e shtresave më të pasura të shoqërisë shqiptare, duke i paraqitur si ushujëza që kanë jetuar me djersën dhe gjakun të varfërve. Përkundër kualifikimeve të deri vonshme, dihet, vetëm zi, në këtë vepër ata na dalin njerëz të suksesshëm që sigurojnë mirëqenien dhe statusin e tyre, por edhe ndihmesën për nevojtarët, dihet, me pasurinë e fituar me punë, inovacion, angazhim vetëmohues dhe sakrificë të mëdha.

Për të qenë më bindës dhe më autentikë, autorët janë nisur nga fshati Sllatinë e Epërme e Anamoravës, duke e zgjeruar pastaj gamën e interesimeve të tyre për historinë dhe mënyrën e shtrirjes së degëve të kësaj familjeje në mjedise të tjera, si: në Shkup, në Prishtinë, në Viti, në Shtime, në Turqi (Izmir, Ankara, Stamboll etj). Autorët, krahas eksplorimeve disavjeçare dhe hulumtimeve këmbëngulëse, kanë

arritur që të mbledhin shumë të dhëna të rëndësishme historike e demografike, sidomos ato të kujtesës që shtrihen në një terren mjaft të shtrirë hapësinor dhe kohor. Kështu, mbi bazën e eksplorimeve të vazhdueshme kanë arritur të përgatisin këtë botim, për mendimin tim, mjaft dinjitoz për familjen Myftiu (Tanëk)

Sipas autorëve, pinjollët e familjes Myftiu vazhdimisht ndanë fatin e bashkatdhetarëve të tjerë dhe u angazhuan me përkushtim për emancipim dhe pavarësi kombëtare që nga periudha e Rilindjes Kombëtare, në qëndresën kundër pushtuesve serbë në fund të vitit 1912 dhe në përballjen me makinerinë gllabëruese të Serbisë, përkatësisht Jugosllavisë deri në prill të vitit 1941. Ata u angazhuan edhe për rikuperimin e statusit dhe të institucioneve shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore në Kosovë dhe më gjerë, sidomos nëpërmjet të Lidhjes II Shqiptare të Prizrenit dhe të mekanizmave të saj. Në fund të Luftës së Dytë Botërore Myftilerët u ballafaquan me valën shkatërruese të formacioneve serbo-jugosllave; më dhunën dhe likuidimet barbare, me vrasjet në kufi dhe me dënimet shumëvjeçare e torturat më të rënda e më mizore nëpër burgjet jugosllave për çka u detyruan të lëshonin trojet e të parëve dhe të shpërnguleshin në Turqi, në vende të ndryshme të Evropës, madje edhe në SHBA, Kanada etj.

**Vepër me interes për
historiografinë dhe etnografinë
shqiptare**

Bazuar në vlerësimin tim, kjo monografi i përmbush plotësisht kriteret shkencore për botim dhe është me interes për historiografinë shqiptare, etnografinë dhe më gjerë. Botimi i kësaj vepre sa shkencore po aq edhe aktuale, edhe pse me vonësë, vjen në një kohë të duhur. Autorët kanë arritur që në këtë vepër-monografi të gërshetojnë natyrshëm historinë e gjeografinë, urbanistikën e etnografinë, ekonominë e tregtinë, bujqësinë e artizanatet, letërsinë e arsimin, kulturën kombëtare e fetare, humanizmin e familjeve më në zë, sakrificën e tyre etj., në tërë përbërësit e në shtrirjen e nevojshme. Ata, në veprën e tyre, jo vetëm që i bëjnë jehonë traditave atdhetare, traditave më të mira të familjeve fisnike për shumë kohë të anatemuara e të injoruara nga push-tuesi, por edhe të përcillen porosi (mesazhe) të fuqishme atdhetarizmi e pune, mesazhe paqeje e krenarie kombëtare, mesazhe përparimtare e demokratike, mesazhe qytetarie e dashurie, mesazhe humanizmi e mirë-kuptimi, mesazhe të mbrojtjes së dinjitetit e të nderit, mesazhe të mirë-kuptimit tradicional ndërfitar midis shqiptarëve, mesazhe të ripërtëritjes e të ngadhënjimit të së drejtës dhe të së mirës, pra të gjithçkaje që është e drejtë, e lartë, e zdrishme e njerëzore. Vepra i krijon kujtudo një përfytyrim të qartë rreth përmasave të kësaj pune të kryer me përkushtim, me dashuri dhe

me përpikëri e mjeshtri (skrupulozitet). Kjo vepër do t'u shërbejë kohëve që po kalojmë, detyrave që shtron çështja kombëtare mbarëshqiptare në trojet etnike e gjetiu në diasporë, do t'i kontribuojë stabilizimit dhe përparimit demokratik të vendit tonë. Autorët, në përgjithësi, kanë pasur një qasje problemore shumë origjinale dhe më një gjuhë dhe stil të rrjedhshëm e të kuptueshëm për të gjithë. Ata i kanë dhënë lexuesit një doracak udhëtimi në të kaluarën e familjes fisnike Myftiu, një udhëtim mes ngjarjesh, njerëzish, historishë intresante, burrash të fortë e bujarë. Duhet shtuar se autorët gjatë shkrimit të tekstit kanë dhënë shënime sqaruese për disa nga protagonistët të këtyre rrjedhave dhe për ngjarjet që lidhen me këtë problematikë, duke e bërë kështu këtë monografi të qartë për lexuesin dhe ndihmesë për studiuesit e kësaj problematike.

Monografia, në vija të përgjithshme, korrespondon me publikimet e tjera të derisotme në historiografinë shqiptare, por tematika e saj është e veçantë dhe origjinale. Ky është një studim që mund të shërbejë si udhërrëfytes për vazhdimin e trajtimet kontributit dhe rolit të familjeve aristokratike në rrjedhat e historisë sonë.

Pra monografia nuk u adresohet vetëm një rrethi të ngushtë lexuesish. Ajo iu drejtohet të gjithëve, të mosshuarve e të rinjve, intelektualëve e studiuesve të fushave të ndryshme të dijes, të kulturës e të krijimtarisë, qytetarëve e fshatarëve të thjeshtë, burrave e grave, sepse të gjithë kanë obligim të

njihen me historinë e gjenealogjinë e familjeve të tyre e më gjerë, sidomos të atyre që kanë reflektuar e kanë dhënë më shumë për atdheun e kombin. Pra, ky libër mund të shërbejë si një model i mirë se si mund të ndërtohen monografi të kësaj natyre për familje të tjera të njohura për të arritur një ditë në një botim akademik sintezë. Duke hedhur dritë në familjen e njohur Myftiu, në organizimin e brendshëm të saj, shtrirjen, objektet e banimit, kopshtet, veprimtarinë ekonomike e shoqërore, arsimore, patriotike e fetare, autorët kanë arritur që sado pak të na njohin edhe me historinë, traditën shekullore, përparimin, qytetërimin, jetën shpirtërore etj. të mjediseve ku kanë jetuar pjesëtarët e saj të shpërndarë gjithandej, duke filluar nga Sllatina e Epërme, Shkupi, Prishtina, Shtimja, Izmiri, Ankaraja, Stambolli etj.

Hedhje dritë në veprimtarinë shumëdimensionale të familjes Myftiu

Një vend të veçantë në këtë monografi zënë portretet e dokumentuara, profilet biografike rreth disa figurave historike të familjes Myftiu, të cilat janë shquar si veprimtarë të çështjes kombëtare, punëtorë shumë të përkushtuar, ekonomistë të mëdhenj, intelektualë të shquar, humanistë të pashe-mbullt. Vlen të nënvizohet gjithashtu përpjekja e autorëve për të hedhur dritë në psikologjinë e anëtarëve më të njohur të familjes Myftiu (Tanëk), duke përmendur shkëlqimin e tyre në ,

aspektin etnografik, paraqitjen e mënyrës së jetesës së kësaj familje të madhe, strukturën e kulturën e saj materiale, shoqërore e artistike, normën e sjelljes, veshjen, virtytet dalluese, si: mikpritjen, besën, burrërinë, humanizmin, altruizmin etj.

Autorët, duke qenë vetë punëtorë të devotshëm të arsimit, nuk e anashkalojnë çështjen e shkollimit dhe veprimtarinë e gjithanshme të shkollave: fetare, private e shtetërore, sidomos kontributin e familjes Myftiu në hapjen e tyre, në mbështetjen morale e materiale të kuadrit arsimor si dhe të fëmijëve e të rinjve.

Autorët kanë vepruar me korrektësi intelektuale dhe me ndershmëri qytetare, duke përmendur referenca të ndryshme, emrat e informuesve që e bëjnë këtë libër-monografi me të vërtetë dokumentare. Shfrytëzimi dhe emërtimi i këtyre burimeve të zgjedhura me dobi, në kuptimin më të mirë të fjalës, veprat e dijetarëve: ato historike, shkencore, letrare, kulturore, fetare, monografi tematike, mbishkrimet objektsh e varresh, pllaka përkujtimore, artikuj në revista e gazeta, kujtime, informacione gojore, fotografi etj., është me interes mjaft të madh.

Përfundim

Mund të përfundohet se autorët i kanë dhënë vetes një detyrë sa të vështirë, aq edhe fisnike, të nxjerrin në dritë një familje që është një vargan malesh me shumë maja. Vargu i njerëzve të ditur dhe i burrave të shquar të familjes Myftiu, për të cilët flitet

në këtë monografi, është shumë i madh. Kështu, autorët ia kanë dalë në përmbushjen e qëllimit të tyre, duke na dhënë kështu një monografi me përmbajtje interesante të bazuar në fakte të pamohueshme. Autorët, falë përkushtimit disavjeçar, me kompetencë dhe objektivitet i kanë bërë një shërbim të mirë jo vetëm familjes Myftiu, por edhe historisë, etnografisë e kulturës sonë në përgjithësi.

Libri, besoj, do lexohet, jo vetëm nga rrethet profesionale shkencore por edhe të një rrethi të gjerë lexuesish, jo vetëm në Kosovë dhe trevat e tjera shqiptare por edhe te shqiptarët në Turqi dhe gjithandej në Mërgatën tonë. Ai i jep mundësi lexuesit që të ndalet e të analizojë me gjakftohtësi, duke nxjerrë jo vetëm vlera të përgjithshme, por edhe të veçanta për disa fusha të dijes.

Muhamet SHATRI

